

(4) Против решението од ставовите (1) и (2) на овој член подносителот на барањето има право да поведе управен спор пред надлежен суд.

(5) Против решението од ставот (3) на овој член подносителот на барањето има право на жалба согласно со Законот за даночна постапка.

(6) Надлежниот орган од ставовите (1), (2) и (3) води евиденција за остварувањето на правото на отпишување на камати согласно со овој закон и се грижи за негово спроведување.

(7) Начинот на водењето на евиденцијата и содржината на евиденцијата од ставот (6) на овој член ги пропишува министерот за труд и социјална политика.

Член 8

На постапката за остварување на правата утврдени со овој закон соодветно се применуваат одредбите од Законот за општата управна постапка.

Член 9

Подзаконските акти предвидени со овој закон ќе се донесат во рок од 15 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 10

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J

PËR SHLYERJEN E KAMATAVE TË DETYRIMEVE TË MATURUARA NË BAZË TË KONTRIBUTEVE NGA SIGURIMI I DETYRUESHËM SOCIAL

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet, mënyra dhe procedura për shlyerjen e kamatave të detyrimeve të maturuara (në tekstin e mëtejme: kamata) në bazë të:

1) kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor të cilat janë shkaktuar përfundimisht me dhjetorin 2008,

2) kontribute nga sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor të cilat janë shkaktuar përfundimisht me dhjetorin 2008 dhe

3) kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social të cilat janë shkaktuar për periudhën nga janari 2009, përfundimisht me dhjetorin 2014.

Neni 2

(1) E drejta e shlyerjes së kamatave në bazë të kontributeve të cekura në nenin 1 të këtij ligji realizohet në bazë të kërkesës së parashtruar nga detyruesi për llogaritjen e kontributeve (në tekstin e mëtejme parashtruesi i kërkesës).

(2) Me dorëzimin e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni konsiderohet se parashtruesi i kërkesës e pranon borxhin kryesor dhe kamatën në bazë të kontributeve të papaguara.

(3) Parashtruesi i kërkesës i cili ka obligime të mbetura nga neni 1 pika 3) të këtij ligji nuk do ta realizojë të drejtën nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse ka detyrime të maturuara dhe kontribute të papaguara nga sigurimi detyrueshëm pensional dhe invalidor ose sigurimi shëndetësor të cilat janë shkaktuar në dhjetor 2008, dhe nuk kanë parashtruar kërkesë për shlyerjen e kamatave për atë periudhë në pajtim me këtë ligj.

Neni 3

(1) Të drejtë të shlyerjes së kamatës për kontributet nga neni 1 pika 1) të këtij ligji ka parashtruesi i kërkesës, nëse bën pagesën e kontributeve në afat prej:

- 12 muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse shumata e përcaktuar e kontributeve të papaguara për sigurim pensional dhe invalidor arrin deri në dhjetë milionë denarë dhe

- 36 muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse shumata e përcaktuar e kontributeve të papaguara për sigurim pensional dhe invalidor arrin mbi dhjetë milionë denarë.

(2) Të drejtë të shlyerjes së kamatës për kontributet nga neni 1 pika 2) të këtij ligji ka parashtruesi i kërkesës, nëse bën pagesën e kontributeve në afat prej:

- 12 muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse shumata e përcaktuar e kontributeve të papaguara për sigurim pensional dhe invalidor arrin deri në dhjetë milionë denarë dhe

- 36 muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse shumata e përcaktuar e kontributeve të papaguara për sigurim pensional arrin mbi dhjetë milionë denarë.

(3) Të drejtë për shlyerjen e kamatës për kontributet nga neni 1 pika 1) të këtij ligji ka edhe parashtruesi i kërkesës i cili është person i vetëpunësuar, bujk individual dhe person zyrtar fetar nëse kryen pagimin e kontributeve në afat prej:

- 12 muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse shumata e përcaktuar e kontributeve të papaguara për sigurim pensional dhe invalidor arrin deri në 120 mijë denarë dhe

- 36 muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse shumata e përcaktuar e kontributeve të papaguara për sigurim pensional dhe invalidor arrin mbi 120 mijë denarë.

(4) Të drejtë për shlyerjen e kamatës për kontributet nga neni 1 pika 2) të këtij ligji ka edhe parashtruesi i kërkesës i cili është person i vetëpunësuar, bujk individual dhe person zyrtar fetar nëse kryen pagimin e kontributeve në afat prej:

- 12 muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse shumata e përcaktuar e kontributeve të papaguara për sigurim shëndetësor arrin deri në 120 mijë denarë dhe

- 36 muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës, nëse shumata e përcaktuar e kontributeve të papaguara për sigurim shëndetësor arrin mbi 120 mijë denarë.

(5) Kërkesa për realizimin e të drejtës nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni parashtrohet në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë më së voni deri më 31 dhjetor 2015.

(6) Kërkesa për realizimin e të drejtës nga paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni parashtrohet në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë më së voni deri më 31 dhjetor 2015.

(7) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni e përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Neni 4

(1) Parashtruesit të kërkesës do t'i kryhet shlyerje e kamatave për kontribute nga neni 1 pika 3) të këtij ligji me shumë prej:

1) 70 % të kamatës nga pagesës së vonuar të detyrimeve të ngelura për të cilat është parashtruar kërkesë nëse pagesën e detyrimeve të ngelura për të cilat është parashtruar kërkesë e kryen në afat prej 12 muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës dhe rregullisht i plotëson detyrimet e maturuara rrjedhëse dhe

2) 50 % të kamatës nga pagesa e vonuar e detyrimeve të ngelura për të cilat është parashtruar kërkesë nëse pagesën e detyrimeve të ngelura për të cilat është parashtruar kërkesë e kryen në afat prej 24 muajve nga dita e parashtrimit të kërkesës dhe rregullisht i plotëson detyrimet e maturuara rrjedhëse.

(2) Llogaritja e kamatës për pagesë të vonuar të detyrimeve të ngecura për të cilat është parashtruar kërkesë, përcaktimi i shumës së kamatës për shlyerjen e kamatës për pagim bëhet pas pagesës së plotë të detyrimeve të ngecura për të cilat është parashtruar kërkesë, nën kushtet e paragrafit (1) të këtij ligji.

(3) Kërkesa për realizimin e të drejtës nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet në Drejtorinë e të Hyrave Publike më së voni deri më 31 dhjetor 2015.

(4) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (3) i këtij neni i përcakton ministri i Financave.

Neni 5

(1) E drejta e shlyerjes së kamatës në bazë të kontributeve nga neni 1 i këtij ligji ka të bëjë edhe me detyrimet e kamatës të cilat janë në procedurë të pagesës së prolonguar, procedurës gjyqësore ose në procedurë të pagesës së detyrueshme.

(2) Organi kompetent i cili udhëheq procedurë për pagesë të prolonguar, procedurë gjyqësore ose procedurë për pagesë të detyrueshme është i obliguar që ta ndërpresë atë dhe t'i mundësojë parashtruesit të kërkesës t'i realizojë të drejtat e këtij ligji, në pajtim me kushtet e përcaktuara.

(3) Parashtruesi i kërkesës i kompenson harxhimet të cilat do të shkaktohen gjatë ndërprerjes së procedurave.

Neni 6

Në rast që obliguesi për llogarinë dhe pagimin e kompensimeve të mos i realizojë dhe paguajë detyrimet rrjedhëse të maturuara dy muaj një pas një, e humb të drejtën e nenit 2 të këtij ligji, ndërsa organi kompetent ngre procedurë për pagim të detyrueshëm të detyrimeve të mbetura dhe të kamatës dhe i vazhdon procedurat e ndërprera.

Neni 7

(1) E drejta e shlyerjes së kamatave nga neni 3 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji përcaktohet me aktvendim të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë pas pagimit të plotë të detyrimeve të ngecura për të cilat është parashtruar kërkesë në pajtim me këtë ligj.

(2) E drejta e shlyerjes së kamatave nga neni 3 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji përcaktohet me aktvendim të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë pas pagimit të plotë të detyrimeve të ngecura për të cilat është parashtruar kërkesë në pajtim me këtë ligj.

(3) E drejta e shlyerjes së kamatës nga neni 4 paragrafi (1) i këtij ligji përcaktohet me aktvendim nga Drejtoria e të Hyrave Publike pas pagimit të plotë të detyrimeve të ngecura për të cilat është parashtruar kërkesë në pajtim me këtë ligj dhe pas pagimit të kryer të një pjese të kamatës e cila nuk është e shlyer.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të ngritë kontest administrativ para gjykatës kushtetuese.

(5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (3) i këtij neni parashtruesi i kërkesës ka të drejtë për ankesë në pajtim me Ligjin për procedurë tatimore.

(6) Organi kompetent nga paragrafët (1), (2) dhe (3) mban evidencë për realizimin e të drejtës për shlyerjen e kamatës në pajtim me këtë ligj dhe kujdeset për zbatimin e tij.

(7) Mënyrën e udhëheqjes së evidencës dhe përmbajtjen e evidencës nga paragrafi (6) i këtij neni e përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Neni 8

Në procedurë për realizimin e të drejtave të përcaktuara me këtë ligj në mënyrë përkatese zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

Neni 9

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

3032.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПРЕВОЗ ВО ПАТНИОТ СООБРАЌАЈ

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за превоз во патниот сообраќај, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 9 јуни 2015 година.

Бр. 08-2517/1
9 јуни 2015 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
д-р **Горге Иванов**, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.

ЗА К О Н ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПРЕВОЗ ВО ПАТНИОТ СООБРАЌАЈ

Член 1

Во Законот за превоз во патниот сообраќај („Службен весник на Република Македонија“ број 68/2004, 127/2006, 114/2009, 83/10, 140/10, 17/11, 53/11, 6/12, 23/13, 120/13, 163/13, 187/13, 42/14, 112/14, 166/14 и 44/15), во членот 5 став 5 на крајот од реченицата точката се брише се става записка и се додаваат зборовите: „за што наплаќа надоместок.“

По ставот 5 се додава нов став 6, кој гласи:
„Висината на надоместокот за извршената проверка за исполнување на посебните техничко-експлоатациони услови за возилата според класата, односно еуро стандардот ја пропишува министерот за транспорт и врски.“

Ставовите 6 и 7 стануваат ставови 7 и 8.